



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Alb-Star” shpk

Adresa: Zona Industriale, Patos, Fier.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia”.

Fondi limit: 346,567,091 (treqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr.106, datë 28.09.2017 për ”Disa Ndryshime në Vendimin Nr. 84, datë 29.12.2016, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017 – 2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 28.12.2017, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 47 datë 30.11.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacdedja” shpk & “Agri Construction” shpk, NUIS K51712017A & NUIS K01725001F

Vlera e ofertës = 294,502,273 (dyqind e nëntëdhjetë e katër milion e pesëqind e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk NUIS J64324443V

Vlera e ofertës = 298,849,113 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë milion e tetëqind e dyzetë e nëntë mijë e njëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Alba Konstruktion” shpk NUIS J61812013R

Vlera e ofertës = 307,703,619.80 (treqind e shtatë milion e shtatëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë pikë tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Edil-Al-IT” shpk & “SMO Union” shpk NUIS J61911003I & NUIS J66902042Q

Vlera e ofertës = 311,250,000 (treqind e njëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “AlbStar” shpk NUIS J62903512W

Vlera e ofertës = **336,792,361** (treqind e tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Curri” shpk NUIS J67902718S

Vlera e ofertës = 346,165,258 (treqind e dyzetë e gjashtë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kacededja” shpk & “Agri Construction” shpk

- Operatori ekonomik “Kacededja” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Tetor 2016 - Tetor 2017 të vërtetuar me....”* pasi në bazë të përqidjes së shprehur në kontratën e bashkëpunimit duhet të disponojë 40 punonjës të paangazhuar në këtë procedurë prokurimi. Numri mesatar I punonjësve është 54 nga të cilët 36 rezultojnë të angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rikonstruktion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo ujit (Faza e dytë)” e cila nuk i ka mbaruar efektet ligjore-tekniko-fianciare. (Akt-Marrëveshje për shtyrje afati Nr. 4389712.Prot, datë 07.12.2017, afati i përfundimit 09.02.2018. Pra mbeten të paangazhuar vetëm 18 punonjës.
- Operatori ekonomik “Agri Konstruktion” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Tetor 2016 - Tetor 2017 të vërtetuar me....”* pasi në bazë të përqidjes së shprehur në kontratën e bashkëpunimit duhet të disponojë 60 punonjës të paangazhuar në këtë procedurë prokurimi. Numri mesatar I punonjësve

është 83 nga të cilët të cilët 44 rezultojnë të angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo ujit (Faza e dytë)” e cila nuk i ka mbaruar efektet ligjore-tekniko-fianaciare. (Akt-Marrëveshje për shtyrje afati Nr. 4389712.Prot, datë 07.12.2017, afati i përfundimit 09.02.2018. Pra mbeten të paangazhuar vetëm 39 punonjës.

- Operatori ekonomik “Kacededja” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë me eksperiencë pune minimale 5 (pesë) vjet, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme....”* pasi Drejtuesja teknike Suzana Mullaha rezulton e angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo ujit (Faza e dytë)” e cila nuk i ka mbaruar efektet ligjore-tekniko-fianaciare. (Akt-Marrëveshje për shtyrje afati Nr. 4389712.Prot, datë 07.12.2017, afati i përfundimit 09.02.2018.
- Operatori ekonomik “Agri Construction” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë me eksperiencë pune minimale 5 (pesë) vjet, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme....”* pasi Drejtuesja teknike Suzana Carkanji rezulton e angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo ujit (Faza e dytë)” e cila nuk i ka mbaruar efektet ligjore-tekniko-fianaciare. (Akt-Marrëveshje për shtyrje afati Nr. 4389712.Prot, datë 07.12.2017, afati i përfundimit 09.02.2018.
- Operatori ekonomik “Kacededja” shpk nuk gërmën “g” të pikës 16 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).”* pasi Mjetet- Kamionme targë AA263FK, Kamioncinë AA479EU, Kamion TR0344, Fadrome AD MT79, Kamion TR8115E, Kamion AA305GT, Autovinc TR9082T, Kamion AA417NZ, Kamioncinë AA174JD, Autobot Uji TR7663S rezultojnë të gjitha të angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo ujit (Faza e dytë)” e cila nuk i ka mbaruar efektet ligjore-tekniko-fianaciare. (Akt-Marrëveshje për shtyrje afati Nr. 4389712.Prot, datë 07.12.2017, afati i përfundimit 09.02.2018.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “G.P.G” shpk

- Operatori ekonomik “G.P.G” shpk nuk gërmën “g” të pikës 16 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Makinëritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor; Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).”* pasi Mjeti, Autobot Uji me targë AA685DN i deklaruar në Shtojcën 9, rezulton të jetë deklaruar në procedurën për të cilin operatori ekonomik është shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, me objekt: **“Rehabilitimi i aksit Mbikalim-Kombinat”**.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Alba Construksion” shpk

- Operatori ekonomik “Alba Construction” shpk nuk plotëson kriterin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit: *“ Grafiku i Punimeve: Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike”* pasi nuk është paraqitur grafik punimesh.
- Operatori ekonomik “Alba Construction” shpk nuk plotëson kriterin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit: *“ Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 10 (dhjetë) copë”* pasi me faturë janë paraqitur 5 nga 10 copë të kërkuara.
- Operatori ekonomik “Alba Construction” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Autobetoniere”* pasi për mjetin Autobetoniere me targë DR1892F polica e sigurimit ka skaduar në datë 26.12.2017 cka bie në kundërshtim me gërmën “a” të pikës 16: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes”*
- Operatori ekonomik “Alba Construction” shpk nuk plotëson gërmën “e” të pikës 16 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”* pasi për mjetin Autobetoniere me targë DR1892F nuk është paraqitur foto.
- Operatori ekonomik “Alba Construction” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Autobetoniere”* pasi për mjetin Autobetoniere me targë AA295DS nuk është paraqitur Çertifikatë për Transport Mallrash brenda vëndit cka bie në kundërshtim me gërmën “a” të pikës 16: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e*

mjetit: b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes”

- Operatori ekonomik “Alba Construction” shpk nuk plotëson gërmën “e” të pikës 16 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit*” pasi për mejetin Autobot Uji me targë AA823MP nuk është paraqitur foto.
- Operatori ekonomik “Alba Construction” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Gjenerator” pasi mjeti Gjenerator është deklaruar në Shtojcën 9 por nuk është paraqitur dokumentacioni përkatës/faturë.

4. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Edil-Al-IT” shpk & “SMO Union” shpk

- Operatori ekonomik “Edil-AL-It” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapaciteti ekonomik dhe fianciar të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2014, 2015, 2016), të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar*” pasi për Bilancin e vitit 2014 mungon Vula e Konfirmimit nga Tatimet në cdo faqe.
- Operatori ekonomik “Edil-Al-It” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Autobetoniere” pasi për mejetin Autobetoniere me targë TR6489N nuk është paraqitur asnjë dokumentacion përvec fotos cka bie në kundërshtim me gërmën “a” të pikës 16: “*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes”.*
- Operatori ekonomik “Edil-Al-It” shpk nuk plotëson pikën 10 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2008 (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)*” pasi kjo Çertifikatë rezulton e papërkthyer në gjuhën shqipe cka bie në kundërshtim me

pikën 4.6 të Seksionit 3 të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje/Shqip”.

- Operatori ekonomik “Edil-Al-It” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 14001-2004 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)” pasi kjo Çertifikatë rezulton e papërkthyer në gjuhën shqipe cka bie në kundërshtim me pikën 4.6 të Seksionit 3 të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje/Shqip”.
- Operatori ekonomik “Edil-Al-It” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **OHSAS 18001-2007(e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën OHSAS)” pasi kjo Çertifikatë rezulton e papërkthyer në gjuhën shqipe cka bie në kundërshtim me pikën 4.6 të Seksionit 3 të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje/Shqip”.
- Operatori ekonomik “Edil-Al-It” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë **ISO 39001 -2012 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)” pasi kjo Çertifikatë rezulton e papërkthyer në gjuhën shqipe cka bie në kundërshtim me pikën 4.6 të Seksionit 3 të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje/Shqip”.
- Operatori ekonomik “Edil-Al-It” shpk nuk plotëson pikën 14 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë **PAS 99-2012 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)” pasi kjo Çertifikatë rezulton e papërkthyer në gjuhën shqipe cka bie në kundërshtim me pikën 4.6 të Seksionit 3 të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje/Shqip”.
- Operatori ekonomik “Edil-Al-It” shpk nuk plotëson pikën 15 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatë **ISO 50001 -2011 (e vlefshme)**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO)” pasi kjo Çertifikatë rezulton e papërkthyer në gjuhën shqipe cka bie në kundërshtim me pikën 4.6 të Seksionit 3 të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje/Shqip”.
- Operatori ekonomik “SMO Union” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit teknik të Dokumentat Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm” pasi Urdhëri i Mjekut është paraqitur fotokopje i pa shoqëruar me vertetimin e noterizimit/njehsimit të fotokopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me Kriterin e paraqitur në Dokumentat standarte të Tenderit: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre”.

5. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Curri” shpk

Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Një punësim mesatar i të paktën 100 (njëqind) personave, për periudhën Tetor 2016 - Tetor 2017 të vërtetuar me....”* pasi numri mesatar I punonjësve është 170 nga të cilët 90 rezultojnë të angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me objekt: *“Rikonstruksion i Infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rrugët “Zogu i I-rë” – rruga “Dibrës” – “Siri Kodra” dhe Reshit Petrela”* e cila nuk i ka mbaruar efektet ligjore-tekniko-fianaciare lidhur në datë 27.09.2017, me afat 7 (shtatë) muaj kalendarikë duke nisur nga data e lidhjes së kontratës. Pra mbeten të paangazhuar vetëm 80 punonjës

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Albstar” shpk**, me adresë: **Zona Industriale, Patos, Fier**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **336,792,361** (treqind e tridhjetë e gjashtë million e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.01.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë nuk u paraqit asnje ankese.